



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr. 1 prot.

Prrenjas, më 01.06.2021

Lënda:

**NJOFTIM PUBLIK PËR PRIVATIZIMET E BANESAVE DHE OBJEKTEVE TË
KTHYERA NË FOND BANESE.**

-Mbështetur në VKM-në nr.898 datë 18.11.2020, njoftojmë të gjithë personat e interesuar për Privatizimin e Banesës/Objekteve të kthyer në Fond Banese të dorëzojnë pranë Bashkisë Prrenjas kërkesën për privatizim dhe dokumentacionin bashkangjitur në rrugë postare brenda 1 (një) muaji nga njoftimi :

Kërkesa duhet të përmbajë të dhënat, si më poshtë vijon:

- a) njësinë e vetëqeverisjes vendore së cilës i drejtohet;
- b) të dhënat personale të plota të subjektit kërkuar;
- c) të dhënat lidhur me banesën ose objektin e kthyer në fond banese, për të cilin kërkohet privatizimi, me përjashtim të rastit kur këto të dhëna i kanë EKB-ja apo njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- ç) datën e kërkesës e nënshkrimit të kërkuar; dhe
- d) adresën e komunikimit, duke përfshirë dhe adresën elektronike në zgjedhje të subjektit.

-Brenda 2 (dy) muajve nga marrja e njoftimit nga EKB-ja ose njësia e vetëqeverisjes vendore, përfutuesi duhet të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm për privatizim. Dokumentacioni duhet të përmbajë:

- a) kërkesën me shkrim të qytetarit për privatizimin e banesës së miratuar;
- b) dokumentin e identifikimit të kërkuar (letërnjoftim dhe/ose pasaportë biometrike);
- c) autorizimin për strehim, lëshuar nga organet kompetente, nëse ka një të tillë;
- ç) vendimin e këshillit të njësive të vetëqeverisjes vendore, referuar kërkesës së EKB-së, për miratimin e familjes që do të strehohet në banesën e liruar me vendim gjykatë;
- d) certifikatën e gjendjes familjare aktuale për të përcaktuar subjektet që kanë të drejtë privatizimi dhe për përcaktimin e sipërfaqes tepër, mbi normën e banimit, në varësi të numrit të anëtarëve të familjes;
- dh) vërtetimin negativ nga ASHK-ja për të gjithë anëtarët madhorë të familjes se nuk disponojnë njësi banimi në territorin e njësive të vetëqeverisjes vendore ku banojnë aktualisht, të cilën e kanë përfutur më parë nga privatizimi i banesave ose nga programe të strehimit social;
- e) dokumentin nga organet tatimore për kryefamiljarin dhe/ose anëtarët e familjes, nëse ushtrijnë aktivitet privat;

ë) deklaratën me shkrim nga ana e përfituesit për vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur për privatizim;

f) në rastin e shlyerjes së vlerës së privatizimit me këste, dokumentacionin për vërtetimin e të ardhurave familjare, si më poshtë vijon:

i. vërtetim përkatës nga punëdhënësi për vendin e punës/pozicionin dhe të ardhurat neto të kryefamiljarit e të anëtarëve të tjerë të familjes që janë në marrëdhënie pune;

ii. vërtetim nga zyra e ndihmës e përkujdesjes, pranë njësive të vetëqeverisjes vendore përkatëse, për anëtarët e familjes të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar;

iii. vërtetim nga zyra e punësimit të njësive të vetëqeverisjes vendore përkatëse, për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë;

iv. vërtetim nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!

KRYETARI I BASHKISË

NURI BELBA

